

DREJTIMI/PROFILI PROFESONAL RRJETE TË DHËNASH

1. Cili është emërtimi i saktë me të cilin njihen rreshtat e një tablele në një bazë të dhënash? 1 pikë

A) Fushë

B) Çelës

C) Rekord

D) Atribut

2. Cili nga operatorët e mëposhtëm është operator logjik i SQL? 1 pikë

A) And

B) From

C) Select

D) Where

3. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është operator krahasimi? 1 pikë

A) <=

B) >=

C) !=

D) !=

4. Pse SDRAM është më i shpejtë se DRAM i zakonshëm? 1 pikë

A) Bën dy procese për një cikël ore

B) Punon në sinkron me ciklin e orës

C) Përdor arkitekturën dual-channel

D) Ka më pak tranzistorë

5. Një kompani ka selinë kryesore dhe degët e saj. Të gjitha degët lidhen në internet me lidhje të dedikuar

personale. Çfarë lloj routimi është përdorur në këtë rast? 1 pikë

A) Asnjë

B) Dinamike

C) Statike

D) Classless

6. Kur përdorim një switch shumëshresor, në cilën shtresë jemi duke punuar? 1 pikë

A) Shtresën e rrjetit

B) Shtresën e aplikacionit

C) Shtresën e prezantimit

D) Shtresën e sesionit

7. Një klient nuk lidhet dot në Internet. Sipas kërkesës tonë klienti ekzekuton komandën IPCONFIG/ALL në cmd dhe lexon adresen IP 169.254.1.3. Çfarë problemi ka sistemi? 1 pikë

A) Sistemi ka një adresë IP statike

B) Sistemi ka një adresë APIPA

C) Sistemi ka adresë të gabuar

D) Sistemi ka një adresë IP classless

8. Si emërtohet domain-i i parë që instalohet në një strukturë të re forest në Active Directory? 1 pikë

A) Forest root domain

B) Parent root domain

C) Domain tree root

D) Domain root

9. Cila nga alternativat e mëposhtme është një objekt konteineri në një Active Directory? 1 pikë

A) Skedari (Folderi)

B) Grupi

C) Përdoruesi (Useri)

D) Njësia Organizative (OU)

10. Cili është rregulli që përdoret për menaxhimin e grupeve të sigurisë? 1 pikë

A) Rregulli AGLP

B) Rregulli GDLAP

C) Rregulli AGDLP

D) Rregulli RBAC

11. Në një rrjet me adresë IP 192. 10.10.0, me 14 hoste dhe 14 subnet-e përcaktoni:

a) Çfarë klase i përket adresa IP? _____

b) Çfarë custom subnetmask ka ky rrjet? _____

c) Sa është numri total i subnet-eve? _____

d) Sa është numri total i hostëve? _____

4 pikë

12. Jepet tabela “Nxënës”, me atributet si më poshtë: 3 pikë

(IDStudent, IDLënda, Profili)

Cila është sintaksa në SQL, e cila llogarit numrin e studentëve që ndjekin kursin në lëndën e matematikës,

për profilin Rrjete të dhënash?

13. Çfarë quajmë pseudokod, algoritëm dhe bllokskemë? 3 pikë

—

—

—

14. Jepet pseudokodi i vëllimit të kubit. Si do të paraqitej ai në bllokskemë? 3 pikë

-fillim

-vendosen të dhënat hyrëse, gjerësia, gjatësia, lartësia e kubit (gjatësia=gjerësia=lartësia=4)

-llogaritët vëllimi duke shumëzuar gjerësinë, gjatësinë dhe lartësinë

-afishohet rezultati

-fund

IDStudent Lënda Profili

01 Matematikë Zhvillim Web

02 Letërsi Rrjete të dhenash

15. Cili është rezultati i ekzekutimit të kodit të mëposhtëm? 3 pikë

```
#include <iostream>
```

```
përdorim hapësirën e emrit std;
```

```
int main() {
```

```
int x = 8, y = 9, z = 4;
```

```
cout
```

```
<< "8 / 4 is " << x / z << endl
```

```
<< "9 - 4 is " << (float) y - z << endl
```

```
<< "8 * 9 është " << x * y << endl;
```

```
}
```

16. Çfarë është sistemi BIOS dhe ku instalohet ai? 2 pikë

17. Nëse përdoruesi, nxënësi, ndodhet tek njësitë organizative, shkolla, të domain-it arsimi.gov.al, cila është

sintaksa e saktë për të referuar këtë përdorues në CLI (command-line interface)? 3 pikë

18. Cili është shërbimi që përdoret për të siguruar një mekanizëm qendror për menaxhimin e rezolucionit të emrit

NetBIOS në një: 2 pikë

a) kompjuter lokal?

b) rrjet Windows?

19.a) Çfarë është një Mail Server? 1 pikë

b) Cilat janë disa nga mail server-at më të përdorur? Listoni disa prej tyre. 3 pikë

20. Cilat janë karakteristikat e shërbimit DNS që mundësojnë emërtimin e domain-it? 3 pikë

SKEMA E VLERËSIMIT DREJTIMI/PROFILI PROFESIONAL RRJETE TË DHËNASH

Pyetja 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

Përgjigjja C A C B B A B D C C

Pyetja 11

Model përgjigjeje

a. Adresë e klasit C

b. Custom subnet mask 255.255.255.240

c. Nr total i subnet-eve 16

d. Nr total i host-eve 16

4 pikë nëse përcakton saktë klasën e adresës IP, custom mask-ën, numrin e plotë të subnet-eve, numrin total të

hosteve

1 pikë nëse përcakton saktë klasën e adresës IP,

1 pikë custom mask-ën,

1 pikë numrin e plotë të subnet-eve,

1 pikë numrin total të hosteve

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë

Model përgjigjeje:

```
SELECT Count(IDStudent)
```

```
From Nxënës
```

```
Where lënda ="matematikë and profili = "rrjeta të dhënash ;
```

3 pikë nëse përcakton saktë strukturën dhe sintaksën e query në SQL

2 pikë nëse përcakton strukturën

1 pikë nëse shkruan vetëm një operator

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 13 3 pikë

Model përgjigjeje:

a. Pseudokodi është renditja e instruksioneve për zgjidhjen e një problemi të dhënë me fjalë.

b. Algoritmi është një varg instruksionesh të ekzekutueshme

c. Bllokskema është programi i ndertuar përmes simboleve terminale

3 pikë nëse përcakton saktë pseudokodin, përcakton saktë algoritmin, përcakton saktë bllokskemën

1 pikë nëse përcakton saktë pseudokodin

1 pikë nëse përcakton saktë algoritmin

1 pikë nëse përcakton saktë bllokskemën

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 14 3 pikë

Model përgjigjeje

3 pikë nëse përcakton elementet e bllokskemës, shkruan saktë algoritmin

1 pikë nëse përcakton elementet e bllokskemës

2 pikë nëse shkruan saktë algoritmin

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 15 3 pikë

Model përgjigjeje

8 / 4 është 2

9 - 4 është 5

8 * 9 është 72

3 pikë nëse përcakton rezultatin e programit, bën saktë veprimet matematikore

2 pikë nëse përcakton saktë rezultatin e programit

1 pikë nëse bën saktë veprimet

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

gjëresia=4

gjatësia=4

lartësia=4

Vëllimi = gjerësia * gjatësia*latësi

rezultati

fund

fillim

Pyetja 16

Model përgjigjeje

a. BIOS (Basic Input/Output System) është grupi i instruksioneve të nivelit të ulët që përmban të gjitha kodet e duhura

për kontrollin e tastierës, ekranit, ndërfaqesve të disqeve, komunikimin serial dhe shumë funksione të tjera

b. Sistemi BIOS instalohet në një qark të memories që mund të përditësohet në mënyrë elektronike.

2 pikë nëse jep përkufizimin e sistemit BIOS, përcakton vëndin ku instalohet ky sistem

1 pikë nëse jep përkufizimin e sistemit BIOS

1 pikë nëse përcakton vëndin e instalimit

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 17

Model përgjigjeje

cn=nxenesi.ou=shkolla.dc=gov.al

3 pikë nëse përcakton sintaksën dhe e shkruan saktë referimin në CLI

2 pikë nëse përcakton sintaksën

1 pikë nëse përcakton ose shkruan saktë referimin në CLI

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18

Model përgjigjeje

a. LMHosts files

b. Windows Internet Naming Service (WINS)

2 pikë nëse identifikon shërbimet që bëjnë menaxhimin e rezolucionit të emrit në NetBIOS për kompjuter lokal dhe

server rrjeti

1 pikë nëse identifikon shërbimet që bëjnë menaxhimin e rezolucionit të emrit në NetBIOS për kompjuter

1 pikë nëse identifikon shërbimet që bëjnë menaxhimin e rezolucionit të emrit në NetBIOS për server rrjeti

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19

Model përgjigjeje

a. Një mail server është një version elektronik i postierit. Çdo email që dërgohet kalon nëpër një seri mail serverash gjatë rrugës tek marrësi. Kalimi nga njëri kompjuter tek tjetëri ndodh në një kohë shumë të shkurtër.

b. Mail serverat ndahen në dy kategori : mail server hyrës dhe dalës. Mail serverat dalës janë SMTP (Simple Mail

Transfer Protocol) ndërsa hyrës janë POP3 (Post Office Protocol, version 3). Mail server IMAP (Internet

Message Access Protocol) ruan kopje të email-eve në server.

4 pikë Nëse përcakton mail server-in dhe llojet e mail server-ave që përdoren më shumë sot.

1 pikë Nëse përcakton se çfarë është një mail server

1 pikë Nëse përcakton kategoritë e mail server-ave

2 pikë Nëse përcakton llojet e mail server-ave

0 pikë Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 20

Model përgjigjeje

a. Emrat DNS janë user-friendly

b. Emrat DNS qëndrojnë me konstant se adresat IP

c. DNS i lejon përdoruesit të lidhen me serverat lokal duke përdorur konvencione emërimi si internet.

3 pikë nëse shkruan tri karakteristika të DNS

1 pikë nëse shkruan vetëm një nga karakteristikat

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

www.maturashteterore.com